

A K T - T H E M E L I M I



Sot me date 15.09-20⁰¹(dymije e nje),SAMIR MANE, i Fatmirit dhe i dtl 1967,banues ne Tirane,madhor,me zotesi te plote juridike e per te vepruar, me pashaporte 1710476.

me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar:

NENI 1

Themeloj shoqerine tregtare me pergjesi te kufizuar me emertimin " NEPTUN SHPK"me seli ne Tirane,Rruga " Zonja Curre",Nr 30,Tirane.

NENI 2

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke qe i perket vetem ortakut te vetem Samir Mane.

NENI 3

Shoqeria " NEPTUN",shpk gezon statusin e personit juridik.veprimtaria e e saj do te zhvillohet sipas dispozitave te statutit te saj si dhe te legjislacioneve ne fuqi.

NENI 4

veprimtaria e shoqerise si person juridik fillon me aprovimin e krijimit te saj nga organet kompetente te shtetit dhe do te vazhdoj per nje periudhe kohe prej 10 vjesh,me te drejte perseritje.

Shoqeria mbaron aktivitetin e saj me kalimin e afatit te parashikuar ne kete akt themelimi,neqoftese themeluesi me vullnetin e tij te lire nuk e zgjedh kete afat.

NENI 5

Shoqeria " NEPTUN",shpk do te kete si objekt : Tregtimin e mallrave industriale me shumice e pakice,eksportimin -importimin e tyre.

NENI 6

Shoqeria ka te drejte te krijojte filiale te saj brenda dhe jashte vendit ne cdo kohe qe do te cmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

NENI 7

Fitimi neto qe do te realizohet nga ky aktivitet i perket ortakut te vetem te kesaj shoqerie.

NENI 8

Per detyrimet qe do te krijohen ndaj personave te trete gjate aktivitetit te kesaj shoqerie,ortaku i vetem pergjigjet vetem me kapitalin e shoqerise. Ortaku nuk mban pergjegjesi per detyrimet e shoqerise me pasurine e t

Suz.



qe nuk ben pjese ne kapitakin e kesaj shoqerie.

NENI 9

Maredheniet e punes ne filiale ose ne shqoeri rregullohen nepermjet kontrates se punes.

NENI 10

Dispozita te hollesoshme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

Themeluesi i kesaj shoqerie pasi e lexoi dhe e gjeti konforme vullnetit te tij e firmosi vullnetarisht akt themelimin .

O R T A K U I V E T E M

SAMIR MANE

Samir Mane
Samir

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE Nr 4001 ep.Nr 561 Kol.

V E R T E T I M

Sot me date 24.09.2001(dymije e nje),u paraqit personalisht para meje noteres Tirane,ortaku i vetem i shoqerise " NEPTUN" SHPK,Samir Mane, madhor,me zotesi te plote juridike e per te vepruar,me pashaporte 1710476, i cili kerkoi te vertetoje akt themelimin e shoqerise,une noteria e vertetoj ate konforme ligjes.

N O T E R E





S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA

" NEPTUN " SH.P.K

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te Kufizuar " NEPTUN" SHPK eshte krijuar sipas Akt Themelimit qe eshte perpiluar dhe nenshkruar nga Œrtaku i vetem Themeluesi i saj Samir Mane i biri i Fatmirit dhe i dtl 1967,banues ne Tirane.

NENI 2

Emertimi i shoqerise eshte " NEPTUN " SHPK.

NENI 3

Shoqeria e percaktuar nen nenin 1 te ketij statuti krijohet me mjetet ne pronesi private te themeluesit te saj.

NENI 4

Shoqeria me Pergjegjesi te kufizuar " NEPTUN" SHPK ne perputhje me vendimin per krijimin e kesaj shoqerie dhe me legjislacionin shqiptar rregullon poziten juridike te themeluesit dhe te punonjesve ne shoqeri,te dhenat me rendesi per veprimet juridike,organizimin,objektin e aktivitetin dhe ceshtjeve te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

NENI 5

Shoqeria " NEPTUN" SHPK eshte person juridik shqiptar dhe fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit ne organet perkatese.

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj,kontraten dhe ne kete statut.

NENI 6

Selia e shoqerise " NEPTUN" SHPK ndodhet ne Tirane,Rruga " Zonja Curre" Nr 30,Tirane.

NENI 7

Administrator i shoqerise eshte SAMIR MANE,i cili ka te drejten e delegimit per persona te tjere.

NENI 8

Shoqëria ka vullen e sa te nenshkruar " NEPTUN" SHPK.

NENI 9

Shoqëria ka per objekt : Tregtimin e mallrave me shumice e pakice, importimin-eksportimin e mallrave industriale.

NENI 10

Shoqëria ushtron aktivitetin e vet te percaktuar ne kete statut ne teritorin e Republikës se Shqipërisë. Per kryejren e ketij aktiviteti shoqëria mund te cele dege dhe filiale te saj te perfaqesimit brenda dhe jashte vendit ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe te vendit ku do te hapen.

NENI 11

Shoqëria kryen aktivitetin e saj per te realizuar fitimin e saj duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit.

KREU II

NENI 12

Aktiviteti i shoqërisë realizohet ne baze te veprimtarisë kontabel dhe pasqyrohet ne bilancin e saj.

NENI 13

Per te bere te mundur zhvillimin e shoqërisë caktohet një kapital themeltar prej 100.000 leke i cili eshte kontribut i ortakut te vetem te shoqërisë.

NENI 14

Pjeset e kapitalit themeltar jane plotesisht te trasferueshme ne rruge trashegimie ne rast ndarje pasurie ndermjet bashkeshortëve dhe paraarësive e pasardhësive.

NENI 15

Shoqëria ne emer te vet eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj, por gjithmone ne perputhje me qellimin dhe objektin e aktivitetin qe ajo kryen. Shoqëria mund te shese pasuir ose te shfrytëzoje te drejta te tjera materiale. Ajo mund te ofroj garanci edhe pasuir te saj per te mare kredi bankare.

NENI 16

Shoqëria krijon fonde rezerve ose fonde te tjera te vecanta dhe nxitjen e aktivitetit te saj.

Shoqeria disponon mjetet e veta finaciare. Detyrimet eventuale qe mund te arrijin gjate veprimtarise se saj, mbulohen nga fondi rezerve, nga fondet e tjera ose shumat e tjera suplementare qe mund te derdhen nga ortakut ne rastet kur keto detyrime nuk mund te mbulohen nga fondet ekzistuese.

KREU III

VITI FINACIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMIT.

NENI 17

Odo vit financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

Perjashtimisht viti i pare financiar ka filluar ne ditën e regjistrimit te shoqerise dhe perfundon me 31 dhjetor te viti 2001.

NENI 18

Llogarite vjetore, inventari, operacionet e viti financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga asambleja. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarive vjetore brenda nje afati 6 muajsh nga data e mbylljes se viti financiar.

NENI 19

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria, mbasi zbriten te gjitha detyrimet si dhe fondet e lena rezerve per nxitjen ekonomike per investime per reklamen tregtare i perfoton ortakut i shoqerise.

NENI 20

Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 marsit te viti pasardhe.

KREU IV ADMINISTRIMI

NENI 21

Ortakut perballon humbjen e shoqerise deri ne kufirin e vleres se tij te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar.

NENI 22

Organi vendimor i shoqerise eshte ASAMBLEJA E ORTAKEVE.

Mbledhja e ortakeve e Asamblese mund te thirret nga Administratori, eksperti kontabel i autorizuar ose nga likujduesit.

NENI 23

Administrimi i shoqerise behet nga administratori. Ne shoqerine "NEPTUN" administrator eshte Samir Mane i cili ne te njejten kohe ka dhe funksionimin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet me gjithë veprimtarine e saj.



 Administratori ka te gjitha te drejtat dhe kompetencat per te kryer veprimet ne interes te shoqerise dhe ne mer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh.

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkeljet e ligjit, staturit apo per faj te tij.

NENI 24

Kompetencat e administratorit ne shoqeri jane:

Te miratoj planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise.

Te bej propozime te nevojshme ne mbledhjen e Asamblese kur lind nevoja e ndryshimit te kapitalit themeltar.

Te miratoje akte normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin dhe personelin.

Te percaktoj strukturen e aparatit te shoqerise.

Te krijoj organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te shoqerise.

Te propozoje ne Mbledhjen e Asamblese per krijimin e njesive struktura ve te shoqerise, si filiale dege e perfqesi ne qytete te tjera te vendit dhe jashte tij.

Te pergatis propozimin per pushimin e veprimtarise se shoqerise dhe x tia paraqes asamblese per miratim.

Te siguroje zbatimin e perpikte te vendimeve te Asamblese.

Te percaktoje numerin e punjosve te shoqerise dhe pagat e tyre.

NENI 25

Kontraolli i shoqerise mund te kryehet nga nje ekspert kontabel i autorizuar i emeruar per tre vite me mundesim rizgjedhje. Ai caktohet nga administratori i shoqerise. Shkarkimi i tij vendoset ne te njejtat kondita si emerimi.

NENI 26


KREU V KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Afati i veprimtarise se shoqerise caktohet deri me 2011 duke filluar nga viti 2001 si vit i pare i veprimtarise.

KREU VI

MAREDHENIET E PUNES

NENI 27



Mareveshja e punes ne shoqeri rregullohet ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise,legjislacionin shqiptar dhe me kete statut.

NENI 28

Punesimi i punjonjesve behet ne baze te kontrates kolektive dhe individuale te punes.

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje:

Kushtet dhe menyra e maredhenies se punes.

Puna e nates,puna jashte orarit,puna ne ditet e pushimit javor, festat zyrtare.

Mbrojtja e punes dhe kushtet e punes.

PUshimet dhe pagesat.

Te drejtat,detyrimet dhe pergjegjesite e punonjesve per zbatimin e detyrave te punes.

Pushimi i maredhenies se punes.

Paga e punonjesve,shperblimi i punes dhe shperblime te tjera.

NENI 29

Shoqeria mer persiper te bej sigurimin e punonjesve te punesuar prane saj ne organet perktase duke derdhur regullisht kontributet ne pergjindje te caktuar sipas dispozitave ne fuqi.

NENI 30

Te gjitha mosmareveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata e rrethit Tirane.

NENI 31 KREU VII

MBYLLJA E SHOQERISE

Aktiviteti i shoqerise mbaron ne afatin e percaktuar ne aktin e Themelimit,veprimtaria e shoqerise mund te mbyllet edhe kur gjate dy viteve te njepasnjeshme ky aktivitet i shoqerise nuk rezulton rentabel ose kur ortakut i vetem i saj heq dore nga shoqeria.

NENI 32

Kur shoqeria likujdohet asambleja mbledh komisionin e likujdimit i cili paraqet per miratim bilancin e likujdimit te shoqerise.

Sign.

Shoqeria i jep fund aktivitetit ne castin e miratimit te bilancit te likuidimit-

NENI 33

Mjetet finaciare dhe cdo pronesi tjeter e fituar si rezultat i vep-
rimtarise se shoqerise kur shoqeria likujdohet i takojne ortakut te vetem
te saj pasi te jene zbritur ose bere pagesat per te gjitha kreditorët e
shoqerise.

NENI 34

Te gjitha veprimet e shoqerise regjistrohen ne nje liber te vecante qe
mbahet ne seline e shoqerise.

NENI 35

Ky statut eshte hartuar sot me date 22 o 09.2001 per shoqerine
" NEPTUN " SHPK.

O R T A K U I V E T E M

SAMIR MANE

Samir Mane
f. imp.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE Nr 4001 ep.Nr 061 KOL.

V E R T E T I M

Sot me date 24.09.2001(dymije e nje),u paraqit personalisht para
meje noteres Tirane,SAMIR MANE,ortaku i vetem i shoqerise " NEPTUN"shpk
madhor,me zotesi te plote juridike e per te vepruar,me pashaporte 1710476
i cili kerkoi vertetimin e statutit te shoqerise,une noteria e vertetoj a
ate konforme ligjes.

